



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:261043

Datë: 22.02.2023

Numri i dokumentit: 04001175

ARJ nr.9/2023

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani kryetar, Nebojša Boričić dhe Milena Djerić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B. H. nga P., sipas autorizimit e përfaqëson Nexhat Pula avokat nga P. kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar nga e paditura Komuna e Prishtinës për mes përfaqësuesit sipas autorizimit, Shoq. e Avokatëve Sejdiu & Qerkini, sh.p.k., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. nr. 1034/21 të datës 27.10. 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 10 shkurt 2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet e palejuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga e paditura, Komuna e Prishtinës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. nr. 1034/2021, të datës 27.10.2022.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AA nr. 1034/2021, të datës 27.10.2022, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Komuna e Prishtinës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, AA nr.1178/2019 i datës 14.10.2021, vërtetohet, e me të cilin, në pikën I. të dispozitivit, Aprovohet padia e paditësit B. H. nga P. si e bazuar. Në pikën II. Anullohet aktvendimi nr. 10-430/06-191723 i datës 27.04.2018, i Bordit të Ankesave-Komuna e Prishtinës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër aktgjykimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit, e paditura Komuna e Prishtinës për mes përfaqësuesit të lartë cekur, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e

aktgjykimeve të shkallës së parë dhe të dytë për shkak të; shkeljes së dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, kërkesa e të paditurës Komuna e Prishtinës të aprovohet në tërësi si e bazuar kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të anulohen Aktgjykimi e lartë cekur i shkallës së parë A nr. 1178/19 i dt.14.10.2021, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AA nr. 1034/2021 dhe çështja të kthehet në rishqyrtim.

Gjykata Supreme pasi i shqyrtoi pretendimet e të paditurës në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, vlerësimit të aktgjyqimit të kontestuar dhe atij të shkallës së parë dhe shkresave tjera të lëndës, në kuptim të nenit 52.1, të Ligjit për konfliktet administrative, gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e palejueshme.

Me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet që kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrijë vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes. Me nenin 50 të Ligjit për Konfliktet Administrative, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i parashtrijë gjykatës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit të vendimit kundër të cilit paraqitet kërkesa.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartë cekura të Ligjit për Konfliktet Administrative, kjo gjykatë gjen se pala mundet të parashtrijë kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, vetëm kundër vendimit të plotfuqishëm të gjykatës së shkallës së dytë për çështje administrative. Pasi që me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr. 1034/2021, të datës 27.10.2022, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1178/2019 i datës 14.10.2021, me të cilin aprovohet si e bazuar padia e paditësit B. H. nga P., ndërsa anulohet vendimi i të paditurit nr. 10-430/06-191723 i datës 27.04.2018, i Bordit të Ankesave-Komuna e Prishtinës dhe lënda i është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Me këtë mënyrë të vendosjes nga gjykatat e instancave më të ulëta nuk bëhet fjalë për vendim të plotfuqishëm gjyqësor dhe vendosje meritore, sepse lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë si të palejuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 52 paragraf 1, lidhur me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
ARJ nr.9/2023, me datë 10 Shkurt 2023

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani